



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 113

Nr: 19.02.2025

Ora: 13:00

**VENDIM**

**PËR**

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV BAZUAR NË DENONCIMIN NR. 15 ID,  
DATË 13.02.2025, TË REGJISTRIT TË DENONCIMEVE, TË KOALICIONIT  
PËR REFORMA, INTEGRIM DHE INSTITUCIONE TË  
KONSOLIDUARA/KRIIK**

Sot më datë 19.02.2025, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mori në shqyrtim çështjen administrative me:

**KËRKUES:** Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara/ KRIIK

**SUBJEKT:** **Z. Gerti Janaqi**

Drejtor i Përgjithshëm, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit  
Parauniversitar

**Zj. Rezata Alla**

Drejtor i Përgjithshëm; Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar

**Z. Hasbi Lika**

Drejtorja Rajonale e Arsimit Parauniversitar Tiranë

**Zj. Zaira Gjika**

Drejtorja Rajonale e Arsimit Parauniversitar Fier

**Zj. Bora Sala**

Drejtorja Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës

Nr: 113    Data: 19.02.2025

Ora: 13:00



“Për shqyrtimin administrativ bazuar në denoncimin nr. 15 ID, datë 13.02.2025, të regjistrit të denoncimeve, të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe institucione të konsoliduara /KRIIK”

**OBJEKT:** Përdorimi në postimet e aktiviteteve institucionale të disa Institucioneve të varësisë së Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë të sloganeve/hashtageve partiakë/elektoralë

**BAZA LIGJORE:** Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe pika 2, neni 91, pika 1 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nënpika 1.3, pika c, të nenit 3 të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

### **KONSTATOJ:**

Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK), më datë 13.02.2025, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail, denoncimin e administruar në regjistrin e denoncimeve me nr. 15 ID.

Në këtë denoncim KRIIK parashtron sa vijon:

*“Faqet Zyrtare në Facebook të disa Institucioneve të varësisë së Ministrisë së Arsimit dhe Sportit janë duke u përdorur sloganet elektorale të Partisë Socialiste.*

*Këto slogane është vërejtur se i përmban Faqja Zyrtare në Facebook e Institucioneve të mëposhtme:*

- 1. Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar;*
- 2. Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar;*
- 3. Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Tiranë;*
- 4. Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Fier;*
- 5. Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës”.*

Me vendimin nr. 91, datë 14.02.2025, të Komisioneri Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ), u vendos fillimi i procedurës administrative, për shqyrtimin e këtij denoncimi.

Bazuar në këtë vendim iu kërkua personave përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar, Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Tiranë, Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Fier dhe Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës, të paraqesin rapartet në lidhje me çështjen objekt hetimi.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve administroi pretendimet e Drejtorisë së Përgjithshme e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Tiranë, Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Fier, Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Agjencisë

Kombëtare të Arsimit Parauniversitar dërguara me e-mail në. Sipas këtyre pretendimeve deklarohet se:

*“Këto hashtage nuk kanë pasur logo, simbolika, apo ngjyra karakteristike në mënyrë që të dalloheshin nga personat që kanë shpërndarë postimet. Institucioni ynë nuk kishte dijeni dhe nuk janë vënë re, që këto hashtage, kanë përmbajtje elektorale në faqet zyrtare të institucioneve publike, për të cilat vlerësohet nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, si përdorim i burimeve publike. Përmbajtja e tyre lidhet me investimet në infrastrukturë arsimore, e cila i vjen në ndihmë rritjes së cilësisë së mësimdhënies, zhvillimit profesional të mësuesve, integritit të teknologjisë së informacionit në lëndë të ndryshme të kurrikulës zyrtare të arsimit parauniversitar etj.*

*Pas vënies në dijeni të kësaj situatë, kemi reflektuar mbi rëndësinë e veprimit dhe jemi të angazhuar që të shmangim plotësisht situatën të tillën në të ardhmen, duke bërë të mundur fshirjen e këtyre postimeve si dhe angazhimin tonë maksimal për mos u përsëritur më kjo dukuri.*

*Duam t'ju sigurojmë se veprimet tona në këtë rast nuk kanë qenë në kundërshtim me interesat e institucionit dhe se i qëndrojmë besnik parimeve të etikës dhe transparencës në detyrën tonë. Duke marrë parasysh sa më sipër, kërkojmë mirëkuptimin tuaj dhe Ju garantojmë që nuk do të përsëriten situatën të ngjashme në të ardhmen. Në këto kushte vlerësojmë se, duhet të mirëkuptohet situatën e krijuar duke marrë parasysh se nuk ka pasur asnjë postim me nuanca politike të dukshme nga ana jonë dhe të pushohet hetimi administrativ.”*

Më datë 19.02.2025, ora 13:00, u zhvillua seanca dëgjimore, ku u ftuan të gjitha palët në proces për t'u shprehur në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi. Në tërësi palët i qëndruan pretendimeve të depozituara elektronikisht.

Në vlerësim të pretendimeve të palëve, fakteve dhe provave të administruara në këtë shqyrtim administrativ çmohet se kërkimi sipas objektit i KRIIK, është i mbështetur në ligj, përkatësisht në nenin 91, pika, 1 të Kodit Zgjedhor, *“Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administruar të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia”*. Po ky nen parashikon se **“burime”** quhen asetet e luajshme dhe të paluajshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit”.

Nga hetimi administrativ u provua se postimet, ripostimet dhe pëlqimet janë bërë në faqet zyrtare të rrjetit social “Facebook” të institucioneve subjekt i këtij denoncimi.

Pas verifikimeve të kryera nga ana jonë, u konstatua se postimet, ripostimet dhe pëlqimet, me karakter politik janë fshirë nga rrjeti social i Institucionit.

Sa më sipër, vlerësoj se duhet të pushohet hetimi, duke i'u tërhequr vëmendje Drejtuesve të Institucioneve Publike që të tregojnë kujdes të shtuar në publikimin e postimeve apo ripostimeve të ndryshme me përmbajtje politike apo elektorale, duke mos lejuar shpërndarjen dhe ripostimin e veprimtarive politike apo elektorale të Institucioneve të tyre eprore, pasi përbën shkelje të dispozitave ligjore të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, të ndryshuar.

## **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f ” dhe “n”, pika 2, nenin 91 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimin nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, të ndryshuar,

## **V E N D O S:**

1. Pushimin e shqyrtimit administrativ të denoncimit nr. 15 ID, datë 13.02.2025, të Koalicionit për Reforma Integrim dhe Institucione të Konsoliduara/KRIIK.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet adresës së postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**